ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (**KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:*(* **101-24-1560-5-5-8)**
Sa i përket tenderit për*(***Furnizimi me pajisje të TI-së, PC, Laptop***)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ARITECH SHPK_____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI _ ___ _____
(Adresa)

_____Graçanicë_____ _____10500____ _____
(Vendi)(Kodi postar)

_____+383 38 600 500_____ _____
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

_____Fahri Avdiu_____ _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____fahri@aritechks.com_____
(Adresa elektronike)

_____22.04.2024_____ _____
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftesa per oferte eshte publikuar ne e-prokurim me dt. 28.02.2024 *Afati i fundit per dorezim te ofertes ka qene me date 12.03.2024 h 14:00.* *Ne kete aktivitet te prokurimit kane ofertuar gjashte operator ekonomik..* *Aritech shpk per nga çmimi eshte i dyti ne kete projekt tenderues.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Ne pas njoftimit mbi vendimin e AK-se si dhe letres standarde per tenderuesin e eleminuar perkatesisht te Aritech shpk në afat të rregullt kohorë kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim prane AK-së.

Nga AK fillimisht me date 03.04.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, perkatesisht vendimin mbi tenderin e refuzuar.
Ne baze te saj kemi dorezuar kerkesen per Rishqyrtim prane AK-se me date 08.04.2024.
AK pasi ka shqyrtuar kërkesën tonë me datë 12.04.2024 ka derguar pergjigje mbi vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës ku edhe kishte vleresuar kerkesen tone si te pabazuar . Ne nuk kemi qene te kenaqur me vleresimin e tille prandaj duke u bazuar ne LPP paraqesim ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së.
Autoriteti kontraktues nuk e ka marr mundin te i pergjigjet asnje nga kerkesat tona per Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 6
Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

Neni 60
Kriteret për Dhënien e Kontratës

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me date 03.04.2024 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka marr vendim qe te shperblej me kontrate Ilir Kosova Shpk, ndersa eleminon kompanise Aritech shpk me arsyetimin ne vijim:

Citojme:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: nuk i keni plotësuar kërkesat lidhur m
përshtatshmërinë e pranushmërisë dhe përshtatshmërinë administrative të kërkuara n
ftesën për ofertim, nuk e keni plotësuar si duhet - Përshkrimi i Çmimit në Tabelën A. & B
në kolonën - Çmimi pa TVSH - keni shënuar më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetor
si dhe në Tabelën A. & B në kolonën - Vlera e TVSH-së - keni bërë llogaritje të gabuar dh
keni shënuar më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, (*Shih të bashkëngjitur Rregullore*
001-2022 për prokurim publik pika 17.11) - i **papërgjegjshëm**.

Autoriteti Kontraktues i referohet cmimit pa tvsh ne kuptim te numrave pas pikes dhjetore, sikur te kishte qene kerkese qe çmimet duhet te jene pa tvsh.
Ne në oferten financiare kemi vendos çmime fikse me tvsh per te gjitha produktet.
Asnje nga çmimet e ofruara nuk ka asnje numer pas pikes dhjetore.
Çmimet e ofruara jane te vendosura ne fajll te derguar nga Autoriteti Kontraktues, per çudi AK eleminon si te papergjegjshme 3 nga 6 ofertat e dorezuara me arsyetimin e njejte.

Ne rregullore theksohet:
Citojme:

17.11 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t'a përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.

<u>Perfundim Citati</u>

Referenca e AK-se ne rregullore sqaron pikerisht te kunderten e arsyetimit.
Paragrafi:
Citojme:
Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€).
<u>Perfundim Citati</u>

Paragrafi me lart eshte shume i qarte, çmim i specifikuar dhe i deklaruar eshte çmimi i cili do te faturohet, i njejti kalkulohet sikur kemi sqaruar me larte, Aritech shpk ka ofruar per secilin produkt çmim fiks pa asnje numer pas pikës dhjetore, prandaj arsyetimi i Autoritetit tuaj eshte i pasakt.

Paragrafi:
Citojme:

Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore.
<u>Perfundim Citati</u>

Perseri **çmimi i ofertuar** eshte çmim i ofertuar pa asnje numer pas pikes dhjetore.

Vleresojme qe çmimi i ofertuar nuk eshte çmimi pa tvsh, sepse me asnjerin prej tyre nuk behet kalkulim.
AK ka kerkuar çmim njesi dhe total me tvsh, nuk ka vendosur kolone ku do te duhej kalkuluar total i secilit produkt pa tvsh apo total i te gjitha produkteve pa tvsh.
Rregulloret e percaktuara behen per te pasur kuptim, kalkulimi i çmimeve me numrat e percaktuar, te kufizuar ne dy numra pas pikes dhjetore vlen edhe ne kete rast per çmimin e ofertuar, secili prej tyre eshte pa asnje numer pas pikes dhjetore.

Arsyetimi nga AK thekson qe kalkulimin nuk e ben ne baze te formatit te percakuar nga vet AK, por me ndonje format tjeter, sepse ketu nuk kemi te bejme me ndonje llogaritje te cmimeve pa tvsh por te çmimeve te ofertuara me tvsh, ashtu siç thekson Neni 17.11 i rregullores 001-2022.

Nese do te behej matematike e thjesht, pasiqe çmimet e ofertuara nga kompania jone jane me tvsh, pa asnje numer pas pikes dhjetore, atehere pjesa tjeter e tvsh-se eshte obligim shteteror qe duhet te paguhet ashtu siç rezulton nga perpjestimi i cdo çmimi te ofruar, çdo nderhyrje do te ishte shkelje e ligjit te tvsh-se.
Prandaj eshte e pamundur te ruhet çmimi pa tvsh me dy numra pas pikes dhjetore, formula e tvsh-se dhe te ruhet çmimi me tvsh me dy numra pas pikes dhjetore.

Bazuar ne keto me larte dhe ne RRUOP pika 17.11 ku thuhet:

Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore, por ketu nuk thuhet sakt çmimi i ofertuar pa tvsh apo me tvsh, atehere si logjike te shendoshe kemi ardh ne perfundim qe çmimi i ofertuar konsiderohet çmimi fundor i dhene me tvsh, si ne rastin konkret siç kemi ofruar.
Per te vertetuar kete kemi poashtu vendimin e OSHP-se ku eshte marr valid çmimi perfundimtar me tvsh.
Vendimi nr. 962/16 i dates 06.01.2020 bashkangjitur.

Shih printscreen vendimin :

Operatori ekonomik: "SHEKI" sh.p.k. ka ne pozicionin nr. 4 te pershkrimit te cmimit ka ofruar cmimin me tre numra pas presjes dhjetore, mirpo ne cmimin total ka dy numra pas presjes dhjetore. AK ne kete rast eshte **bazuar ne vendimin e OSHP me nr. te protokollit: 523/19, te dates 07/11/**2019 ne te cilin vendim OSHP deklaron: *se cmimi total nuk ka me shume se 2 numra pas presjes dhjetore. Ne dispoziten e RRUOPP-se, nuk thuhet se ne cmimin per njesi, cmimi i ofertuar lejohet qe te shenohet me maksimum me dy numra pas pikes dhjetore, por ne dispoziten e lartecekur thuhet cmimi i ofertuar lejohet qe te shenohet me maksimum dy numra pas pikes dhjetore. Andaj OSHP konstaton se OE ka ofertuar sipas kerkesave te dosjes se tenderit dhe nuk ka dhene cmim me me shume se dy numra pas presjes dhjetore ngase cmimi total i OE i rekomanduar per dhenie te kontrates me TVSH eshte 232,686.00 €. Prov: Vendimi i OSHP me nr. te prot: 523/19 i dates 07/11/2019.*

AK ne kete rast bie ndesh edhe me Nenin 6 te LPP-se, sepse mendon te shperblej me kontrate OE i cili eshte me i shtrenjt sesa oferta e Aritech shpk, e cila eshte e pergjegjshme. Poashtu, vleresojme qe komisioni i vleresimit duhet te bej ekzaminim dhe vleresim te drejt, dhe ne perputhje me rregulloren dhe LPP.

Prandaj duke u bazuar qe çmimet e ofertes tone jane pa asnje numer pas pikes dhjetore, kerkojme nga Autoriteti juaj qe te Rishqyrton vendimin e tij, te khej lenden ne Rivleresim dhe te vendos ne baze te rregullores dhe parimeve te pergjithshme te prokurimit publik.

AK ne refuzimin e kerkeses per Rishqyrtim thekson numrat pas pikes dhjetore per vleren pa tvsh.
Vleresojme qe tvsh eshte vlere e cila nuk i takon te nderhyje AK-se dhe operatorit ekonomik.
Vlerat e theksuara pa tvsh ne kete projekt nuk kane asnje ndikim, nuk nevojiten per asnje lloj matematike, sepse siç kemi theksuar edhe me lart, te gjitha çmimet e ofertuara me tvsh per secilin produkt veç e veç jane pa asnje numer pas pikes dhjetore.

Prandaj konsiderojme qe arsyetimi i eleminimit nuk korespondon me rregulloren e prokurimit publik dhe LPP.

Lidhur me pozicionin 3 te LPP-se, besojme qe mund te llogaritet si gabim aritmetik, i njejti mund te permiresohet sipas rregullores, e njejta nuk e tejkalon vleren 2% te ofertes totale.

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "**Furnizimi me pajisje të TI-së, PC, Laptop)"** me nr. prokurimi **101-24-1560-5-5-8**
ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se, nga "**KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS",** te kerkohet qe tenderi të Rikthehet ne Rivleresim.
Vleresimi te behet ne baze te Rregullores se prokurimit publik dhe LPP-se

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet e pergatitjes se kerkeses per rishqyrtim dhe Ankeses, si dhe humbja e fitimit per kete aktivitet te prokurimit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të
d) Kerkesa per Rishqyrtim
e) Vendimi i AK-se rreth kerkeses per Rishqyrtim
f) Vendim i OSHP-962/19, per situate te ngjajshme

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*